

ABDULHAMIT KIRMIZI, FERID PASHË VLORA - NJË JETË SHTET¹

Libri i historianit tashmë të mirënjohur turk Abdulhamit Kirmizi, mbi jetën dhe veprën e Ferid pashë Vlorës, pinjolli i Vlorajve të Shqipërisë dhe kryeministër model i Perandorisë Osmane, është një punim shkencor i klasit të parë dhe, njëkohësisht historia më e hollësishme dhe më e rëndësishme e shkruar deri më sot mbi këtë figurë me përmasa e rëndësi shqiptare, evropiane dhe botërore. Abdulhamit Kirmizi është pedagog i historisë për periudhën e vonë osmane në Universitetin e Stambollit (Istanbul Şehir Universitesi). Interesat e tij shkencore përfshijnë çështje si biografitë, historia krahasuese, administrata dhe burokracia, autokracia dhe nacionalizmi.² Në këtë këndvështrim, kontributet e tij shkencore në fushën e historisë së shqiptarëve në periudhën e fundit osmane e bëjnë me plot të drejtë jo vetëm një historian të shtetit osman, por edhe një nga figurat më të shquara të studimeve albanologjike sot.

Përgjatë faqeve të librit voluminoz, autori na shoqëron me mjeshtëri në madhësinë dhe peripecitë e jetës së njëres prej figurave më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e njohur tradicionalisht si Rilindje Kombëtare. Në këtë paraqitje autori duket qartë se është familjarizuar jo vetëm me historinë e shqiptarëve në këtë periudhë, por edhe me historinë e familjes së Vlorajve, pasi ky është studimi i dytë madhor i tij mbi historinë e këtij oxhaku të shquar, pas botimit në turqishten e sotme të kujtimeve të vëllait të Ferid Pashës, Syrja bej Vlorës. Stili i zhdërvjellët i rrëfimit ndërthuret me metodën rigorozë shkencore, e mbështetur në një bazë të madhe dokumentare dhe në një literaturë të bollshme e të përzgjedhur me kujdes.

1 Përktheu nga turqishtja Rubin Hoxha, Logos-A, Shkup, 2018, 542 faqe.

2 Librat e botuar prej tij qëndrojnë brenda këtyre kufijve kohorë e tematikë. Titujt e botuar përfshijnë botimin kritik të kujtimeve të Syrja bej Vlorës: *Avlonyalı Sureyya Bey, Osmanlı Sonrası Arnavutluk, 1912-1920*, Istanbul: Klasik, 2009. Po ashtu edhe një studim me rëndësi mbi administratën osmane në periudhën e fundit të shek. XIX, titulluar *Abdülhamid'in Valileri: Osmanlı Vilayet İdaresi, 1895-1908*, Istanbul: Klasik, 2007.

Autori e nis rrëfimin e tij historiografik mbi shqiptarin patriot dhe shtetarin osman Ferid pashë Vlora, duke marrë si shkas një intervistë me gazetarin e gazetës vjeneze “Neue Freie Presse”, në rezidencën e tij në brigjet e Bosforit në prill të vitit 1910. Pas kësaj hyrjeje të gjetur, rrëfimi i historisë së kryeministrit osman dhe atdhetarit shqiptar zhvillohet në mënyrë lineare, por aspak të mërzitshme, nga fëmijëria e deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Ferit pashë Vlora, (*Avlonyalı Ferit Paşa ose Avlonyalı Mehmet Ferit Paşa*), na del i dokumentuar në këtë vepër jo vetëm si nëpunës i administratës, ministër i Punëve të Brendshme, kryeministër s(adrazem), por edhe si ndihmëtar i çështjes kombëtare dhe aktivist i kolonisë shqiptare të Stambollit. Ferit Pasha, i biri i Mustafa Nuri pashë Vlorës dhe Naile hanëm Janinës, lindi në Janinë, në vitin 1852. Babai i tij, nga oxhaku i njohur i Vlorajve, ishte caktuar me punë administrative. Aty kreu ruzhdijen dhe më pas gjimnazin “Zosimea”. Përveç shqipes dhe osmanishtes, ka ditur greqisht, frëngjisht, arabisht e italisht. Më 1867-n u bë sekretar i babait të vet, kur ai ishte mytesarif në Rethimno të Kretës. Më pas, detyrat zyrtare e çuan në skaje të ndryshme të shtetit osman. Ai gjendet në kohë të ndryshme në Heraklion, Mostar, Sarajevë, Stamboll dhe Halep, në shërbimin civil dhe si zyrtar në drejtësi. Mori pjesë në komisione të ndryshme në procesin e reformave të ndërmarra nga shteti osman. Më 1874-n vendoset në Stamboll. Karriera e tij administrative bëhet gjithnjë e më me rëndësi, kur emërohet më 1884-n si anëtar i Departamentit të Reformave.

Në vitin 1898, tashmë me gradën e vezirit, emërohet si vali në Konja, duke bërë shërbime të mëdha aty, duke e modernizuar qytetin me ndërtesa, lulishte, ura e rrugë, magazina dhe baraka ushtarake, shkolla, spitale dhe ujësjellës. Rikonstruktoi monumentet Selxhuke, luftoi kaçakët, nxiti industrinë e tapeteve dhe ndërtoi molin dhe portin e Antaljas. Gjatë kësaj kohe, e shoqja e sëmurë Refete Libohova, e bën të pavolitshëm qëndrimin në klimën e vështirë Konjës. Kështu, ai lëviz drejt Stambollit, në krye të një komisioni, dhe më pas emërohet kryeministër më 15 janar 1903, detyrë të cilën e mbajti deri më 22 korrik 1908, pas rikthimit të kushtetutës së miratuar më 1876, nga Abdylhamiti II, pas revolucionit xhonturk. Sipas raportit të ambasadorit anglez në Stamboll, dërguar Londrës në fund të vitit 1906, thuhej se deri atëherë, si kryeministër, Ferit Pasha ishte treguar një drejtues i aftë dhe administrator i shkathët, i cili ka ditur ta ruajë postin e tij mjaft të vështirë me një sundimtar dyshues dhe mes një panteoni të llojllojshëm ministrash, shumica e të cilëve e urrenin. Po ashtu, nga ky raport mësojmë se i vëllai, Syrja bej Vlora, shërbeu gjithashtu si këshilltar

ekonomik për Abdylhamitin II, dhe më pas, edhe si kryetar i Këshillit të Doganave. Vëllai tjetër, Namik Beu, ishte anëtar i Këshillit të Shëndetësisë. Në të vërtetë, vështirësia e detyrës si kryeministër në një nga periudhat më delikate të historisë osmane e kishte çuar që disa herë të kërkonte dorëheqjen nga posti, dorëheqje e cila gjithnjë u refuzua nga sultani.

Ishte gjithashtu kushëri me Ismail Qemal Vlorën. Në fillim të vitit 1880, ai ishte një nga anëtarët më të zellshëm të Shoqërisë së të Shtypurit të Shkronjave Shqip në Stamboll. Pas represionit hamidist që shtypi Lidhjen e Prizrenit, ai u syrgjynos larg trojeve shqiptare dhe iu përkushtua karrierës administrative, duke u bërë qeveritar i Konjës, përpara emërimit si kryeministër. Caktimi i tij si kryeministër, pas mëse gjysmë shekulli mungese kryeministrash shqiptarë, vinte si pasojë e nevojës së Abdylhamitit II për të përmbajtur shqiptarët, që të mos kërkonin të drejtat që iu takonin. Abdylhamiti sapo kishte shtypur Lidhjen e Pejës dhe për të disatën herë kishte mbyllur të gjitha shkollat fillore në gjuhën shqipe. Tashmë, edhe pse vonë, Abdylhamiti e kishte kuptuar se politika e shtypjes së të drejtave të shqiptarëve dhe turqve e kishte dëmtuar në mënyrë të pariparueshme të ardhmen e shtetit osman. Ferid Pasha, në mënyrë tradicionale shqiptare, i ofroi besën Abdylhamitit që do të punonte për mirëqenien e shtetit dhe nënshtetasve osmanë. Edhe Ferid Pasha, sikurse ishte edhe tradita osmane, u dha poste me rëndësi në administratë bashkatdhetarëve shqiptarë, gjë që në fakt pasqyronte edhe peshën që shqiptarët mbanin në Ballkanin osman.

Edhe pse një administrator i aftë dhe diplomat i zgjuar dhe i mprehtë, në kohën kur erdhi në detyrë, shteti osman po shkonte gjithnjë e më shumë drejt shndërrimit në një shtet të kontrolluar nga Fuqitë e Mëdha, veçanërisht nga Rusia. Ndërhyrja e ambasadorëve të këtyre fuqive në punët e shtetit osman kishte arritur deri në atë pikë, sa që sovraniteti i sultanit dhe i shtetit po bëhej fiktiv.³ Në vitet e qeverisjes ai u përball me një sërë sfidash e vështirësish, të cilat ia doli t'i menaxhojë me aftësi e zgjuarsis prej administratori e shtetari të rrallë. Në vitet 1904-1905, u përball me kryengritjen në Jemen të udhëhequr nga imam Jahja që vazhdoi luftën e nisur nga i ati, imam Mensuri, që në vitin 1891. Po ashtu, që në fillim të punës së tij si kryeministër, një nga problemet kryesore ishte çështja e Ballkanit ose e Rumelisë, ku ndërhyrja e shteteve të huaja kishte arritur deri në pikën kritike të cenimit të hapur të sovranitetit të këtyre shteteve.

3 Ambasadorët e këtyre shteteve të prirë nga ai rus kishin vënë nën kontrollin e tyre, xhandarmërinë, financat dhe drejtësinë. Sa herë kërkonin një koncension politik, kërcënonin direkt sultanin me pushtimin e Stambollit dhe Abdylhamiti, pas një përpjekjeje fillestare për shtyrjen e ultimatumit, pranonte kërkesat e ambasadorëve.

Përveç Bankës Osmane që ishte vendosur nga Abdylhamiti që në vitet 1880 në duart e huaja, po ashtu edhe ndalimi dhe mbyllja e universitetit të vetëm në perandori, atij të Stambollit nga i njëjti sulltan, kishte sjellë një varësi të plotë të elitave osmane të fushës së arsimit në shtetet evropiane dhe nga specialistët e këtyre vendeve. Fuqitë evropiane, tashmë kishin marrë në dorë, përveç financave që i kontrollonin përmes Bankës Osmane dhe Komisionit Financiar, edhe xhandarmërinë apo forcën policore, organizimin ushtarak, dhe tani synonin edhe kontrollin mbi drejtësinë, duke kërkuar me kërcënime të hapura reformën në drejtësi, sipas kërkesave të tyre dhe nën drejtimin e specialistëve të tyre. Madje, ndërhyrja kishte arritur deri aty, saqë, përmes ambasadorëve të tyre, Fuqitë e Mëdha kërkuan që krejt Ballkani t'i nënshtrohej reformës administrative dhe të gjitha vilajetet e Rumelisë të kishin një guvernator të huaj të emëruar prej tyre. (f. 313-319) Bazat e kësaj ndërhyrjeje dhe varësie ishin hedhur vite më parë dhe qëndresa e Ferid Pashës kishte pak mundësi për sukses.⁴ Të gjitha këtyre përpjekjeve Ferid Pasha u përpoq t'u rezistojë, por nuk ishte e lehtë dhe ishte tepër vonë. Në vitin 1905, Ferid pashë Vlora, në cilësinë e kryeministrit të shtetit osman, i deklaroi ambasadorit gjerman në Stamboll, se zgjidhja më e mirë për Ballkanin do të ishte një Shqipëri e pavarur, që të përfshinte të katër vilajetet ku banonin shqiptarët dhe të kufizohej në lindje me shtetin osman.

Jetëgjatësia e tij në detyrë, në një periudhë të vështirë i detyrohej aftësive të dëshmuara të tij për të punuar pa ia vënë veshin intrigave të oborrit sulltanor. E bija e Abdylhamitit, Aishe Sulltan, në kujtimet e saj pohon se në oborrin perandorak qarkullonin thashetheme të llojllojshme mbi të. Pëshpëritej se nuk ishte besnik, se nxiste rebelimet dhe se synimi i tij kryesor ishte të bëhej princ i Shqipërisë. Në fakt, asnjë nga këto thashetheme dhe intriga nuk patën efekt përballë kompetencës dhe aftësisë së tij. Edhe shkarkimi nga posti erdhi si një manovër e sulltanit për të zgjidhur krizën e krijuar nga lëvizja xhonturke. Si shkak i drejtpërdrejtë u përmend mbështetja që u kishte dhënë shqiptarëve të mbledhur në Ferizaj, të cilët kërkuan nga sulltani shpalljen e kushtetutës dhe ndërmarrjen e reformave të përshtatshme për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe të sigurisë. Dëshmitë e bashkëkohësve qartësojnë se Ferid Pasha telegramit të shqiptarëve të mbledhur në Ferizaj dërguar Sulltanit për rivendosjen e kushtetutës, i është përgjigjur në shqip, duke iu thënë

4 Kështu, pika 3 e programit të Myrztëgut parashikonte riorganizimin e vilajeteve të Rumelisë sipas parimit të kombësive dhe kjo i kishte rritur në kulm tensionet mes kombësive për shtrije influence e hapësirë politike.

“...keni bërë punë të mirë dhe Zoti u dhashtë sukses!” (f. 356)

Edhe shtypi evropian i kohës e lidhte shkarkimin e tij nga posti me praninë e shumë shqiptarëve në mesin e konstitucionalistëve dhe animit të tij nga ana e shqiptarëve në kërkesat e tyre.⁵ Edhe pse u shkarkua nga posti i kryeministrit, në korrik të vitit 1908, ai u caktua në detyrën e ministrit të Brendshëm në vitin 1909. Në vitin 1909, kur tashmë ishte ministër i Brendshëm, ai e kritikoi përdorimin e dhunës në qetësimin e situatës në Kosovë, duke u shprehur në parlamentin osman se Shqipëria nuk rregullohet kurrësi me forcën e armëve e me përdorimin e dhunës, por duhej synuar më së pari zhvillimi i vendit përmes hapjes së dijes dhe arsimit. Me këtë rast, ai, duke u solidarizuar me bashkatdhetarët e vet shqiptarë, deklaroi qartë:

“Edhe unë e them me krenari, se jam shqiptar”. (f. 456-466)

Në vitin 1912 u zgjodh kryetar i Dhomës së Lartë të Parlamentit Osman, ose i Senatit. Një nga djemtë e tij, Xhelaludin Pasha, u martua me princeshën Atijetullah Hanim, vajza e madhe e mbretit Abbas II të Egjiptit. Pas kërcënimeve që i vinin nga xhonturqit, Ferid pashë Vlora gjeti strehim të sigurtë në Kajro, në oborrin shqiptar të Egjiptit.

Roli i tij në lëvizjen kombëtare dhe në shpalljen e Pavarësisë është i dokumentuar gjerësisht. Emri i tij përflitej si një nga kandidatët për fronin princëror të Shqipërisë, të njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Vdiq në 21 dhjetor 1914, në San Remo të Italisë, disa muaj pas fillimit të Luftës së Parë Botërore. Sipas amanetit të tij, të bijtë e sollën trupin e pajetë të tij dhe e varrosën në Vlorë, në varrezën e familjes Vloraj. Varri i tij u dhunua dhe u shkatërrua nga barbaria diktatoriale e regjimit enverist.

Libri është i shoqëruar në fund me një shtojcë ku jepet kronologjia e jetës së Ferid Pashës, si edhe me një shtojcë tjetër me dokumente arkivore dhe letra të tij. Përveç kësaj, nuk mungojnë fotografite ilustruese në shtojcën e tretë, të cilat pasohen nga bibliografia dhe treguesi i emrave.

5 “The sympathetic attitude of the Musulman Albanians towards the movement are the chief causes of Ferid’s disgrace, since he, as a member of distinguished Albanian family, is naturally exposed to suspicion of complicity with the mutineers”. The Times, 24 korrik 1908, f. 7.